

REALIZIMET E KOLEKSIONIMEVE

2022

Programi “Për eksplorimin, identifikimin dhe koleksionimin e mostrave të farës dhe materialit shumëzues (copa, rrënjë, etj) të kultivarëve lokal dhe të afërmve të egër të kulturave bujqësore, për plotësimin e boshllëqeve në Bankën Gjenetike Kombëtare të BGJ-së”, miratuar me urdhërin e Rektorit të UBT-së, Nr 264 Prot, datë 27.01.2022.

Zonat e eksplorimit dhe koleksionimit:

- a) Në rajonin jugperëndimor (zona I-rë), disa fshatra të qarkut Vlorës, në bregdetin e Jonit.
- b) Në rajonin verilindor (zona II-të), disa fshatra të qarqeve Dibër dhe Kukës.
- c) Rajone të tjerë ku u mundësua procesi i eksplorimit dhe koleksionimit.

Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit bujqësor në rajonet e marginalizuara të Shqipërisë janë ndjekur në mënyrë të pa përshtatshme. Studimet kanë treguar se kultivarët lokal tradicional, si pjesë e agrobiodiversitetit, shquhen për disa cilësi të veçanta:

- Kanë përshtatje të mirë në kushtet klimatike e tokësore lokale;
- Dallohen për cilësi të lartë organo-leptike të produktit (ngjyrë, shije, aromë, etj);
- Kanë vlera kulturore e historike, si pjesë e trashëgimisë popullore;
- Kanë qëndrueshmëri të mirë ndaj sëmundjeve e dëmtuesve, ruhen mirë gjatë dimrit, etj;
- Piqen më herët se kultivarët modern (Granges et al, 1995), etj.
- Kanë konsumator të qëndrueshëm, në qytete e fshatra.

Ndonëse janë me rëndësi jetike, shumë të afërm të egër të kulturave, që kërcënohen në mjediset e tyre natyrore nga urbanizimi, shpyllëzimi dhe zgjerimi i zonave të bujqësisë, nuk janë koleksionuar dhe nuk ruhen në bankat gjenetike.

Qëllimi i këtij programi ishte kryerja e anketimeve, eksplorimeve dhe koleksionimi i kultivarëve tradicional lokal dhe i të afërmve të egër të rrezikuar, të cilët rriten në fshatrat e rajoneve të sipërcituara dhe që rrezikohen të zhduken si rezultat i eksodit të popullsisë rurale, dëmtimet e habitateve nga bagëtitë dhe ndërtime të shumta për zgjerimin e zonave urbane, zgjerimin dhe zhvillimin e infrastrukturës rrugore dhe asaj turistike, etj.

Rezultatet e programit:

- Në rajonin e bregdetit jonian të Vlorës (zona I-rë): u vizituan 13 fshatra dhe u koleksionuan 69 acc., prej të cilave 47 kultivarë lokal të 23 specieve dhe 22 acc., të afërm të egër të 16 specieve.
- Në rajonin verilindor (zona II-të), në qarqet Dibër dhe Kukës (Bashkia Peshkopi, Mat dhe Klos): u vizituan 27 fshatra dhe u koleksionuan 28 acc., prej të cilave 24 acc., kultivarë lokal të 13 specieve dhe 4 acc., të afërm të egër të 3 specieve.
- Në rajone të tjera: Në masivin kodrinor të Kavajës u vizituan 6 fshatra dhe u koleksionuan 62 acc, prej të cilave 6 acc., kultivarë lokal të 5 specieve dhe 57 acc., të afërm të egër të 36 specieve. Në Lushnjë u gjetën e u koleksionuan koleksionuan 11 acc., të 7 specieve, prej të cilëve 2 acc., të afërm të egër të 2 specieve. Në rajonin Korçë dhe Përmet u koleksionuan 55 acc., të 29 specieve, prej të cilave 41 acc., kultivarë lokal të 18 specieve dhe 14 acc., të afërm të egër të 11 specieve. Në bashkëpunim me Universitetin “Fan S. Noli” të Korçës (Prof. Dr. Robert Damo), si dhe me grupin italian të Universitetit të Catanies (Prof. Dr. Ferdinando

Branca e Simone Treccarichi) u gjetën dhe koleksionuan 18 acc., të 11 specieve, me 2 acc., të afërm të egër. Në disa fshatra të **Përmetit, Korçës dhe Shkodrës**, (kontribut i Prof. Ndoc Fasllia dhe Prof. Petrit Dobi) projekti RASP u koleksionuan 29 mostra fare të kultivarëve lokal, të 18 specieve bimore.

Konkluzione: Shkëmbimi i farave është një traditë mijëra vjeçare e fermerëve dhe kopshtarëve. Kultivimi i bimëve, ruajtja e farave dhe shkëmbimi i tyre ka qënë praktikë e zakonshme përpara industrializimit të sistemit tonë ushqimor. Në shumë pjesë të botës, kjo praktikë është ende një realitet i përditshëm dhe çon në një shumëllojshmëri të gjerë të kulturave të ndryshme dhe një përshtatje të fortë lokale të varieteteve lokale të bimëve të përdorura në prodhimin bujqësor.

Rezultatet e përmbledhura të koleksionimeve 2022 janë: koleksionuar gjithsej 273 acc., nga këto 172 acc., të 81 specieve të kultivarëve lokal dhe 101 acc., të 70 specieve të të afërmeve të egër.

Duke mbledhur të afërmit e egër (të mbi 50 specieve), IRGJB po kontribuon jo vetëm në pasurimin e fondit të materialit gjenetik në koleksionin bazë, por gjithashtu në ruajtjen e biodiversitetit të tyre, veçanërisht në kushtet e mjediset në të cilat ato rriten janë kaq të prekshme nga faktorët shkatërrues. Në zonën kodrinore e malore të bregdetit Jonian dhe kodrat e Kavajës, të afërmit e egër të bimëve të kultivuara perimore rriten në toka skeletike, të pa plehëruara dhe të pa ujitura, madje shpesh herë edhe me prani të dukshme kripëzimi dhe/ ose thatësire të tejskajshme. Përveç ruajtjes së farave, IRGJB po kujdeset që të ruhet sasia dhe cilësia e farave. Në këtë mënyrë, me mostrat e farave të mbledhura, të njohura si aksesione, janë shoqëruar me karakteristikat biomorfologjike të përshkruara. Ato njëherazi zotërojnë karakteristika gjenetike të vlefshme, që mund të parandalojmë zhdukjen e tyre përgjithmonë.

